

OJQ HandiKOS

**Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të pavarur
31 Dhjetor 2021**

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur..	3
Bilanci i Gjendjes.....	5
Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve.....	6
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë.....	7
Pasqyra e Ndryshimeve në Fonde.....	8
Shënimet e pasqyrave financiare.....	9-15

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar: Menaxhmentit te OJQ HandiKOS

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te bashkëngjitura të OJQ HandiKOS (në vijim referuar si "Organizata" apo "HandiKOS") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2021, pasqyrën e të hyrave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe pasqyrën individuale të ndryshimeve në fonde për vitin e mbyllur në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues te përfshira ne fq. 5-15.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Organizatës më 31 Dhjetor 2021, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në pajtim me Parimet e Përgjithshme te Pranueshme te Kontabilitetit.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit ne paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Çështjet kryesore të auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tonë profesional, ishin të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje janë trajtuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit tone më sipër, dhe ne nuk do të japin një opinion të veçantë mbi këto çështje.

Ne kemi vendosur se nuk ka çështje të rëndësishme të auditimit për të komunikuar në raportin tonë.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre te ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare te Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kompanisë për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, te çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuideojë Kompaninë ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit qëpërfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

AuditCheck,


Nijazi Jakupi
Auditor Ligjor
Tel: 044224012



25 Mars, 2022

Pasqyra e Pozitës financiare

	Shënimi	Dhjetor 31, 2021 (në EUR)	Dhjetor 31, 2020 (në EUR)
ASETET			
Asetet qarkulluese			
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	3	387,032	373,772
Grantet e arkëtueshme	4	6,239	3,668
Të arkëtueshmet tjera			
Totali i asetëve qarkulluese		397,271	377,440
Asetet jo-qarkulluese			
Prona, impiantet dhe pajisjet	5	13,426	22,386
		13,426	22,386
TOTALI I ASETËVE		406,697	399,826
DETYRIMET DHE EKUITETI			
Detyrimet rrjedhëse			
Ll. e pagueshme		3,298	1,999
Detyrimet tjera		2,468	2,447
Të hyrat e shtyra	6	400,931	395,380
Totali i detyrimeve rrjedhëse		406,697	399,826
Ekuiteti			
Fondet e bartura			
Deficiti/suficiti neto për vitin			
Totali i ekutetit			
TOTALI I DETYRIMEVE DHE EKUITETIT		406,697	399,826

Këto pasqyra financiar janë aprovuar nga Menaxhmenti i Organizatës me 18 Shkurt 2022 dhe autorizuar për publikim nga:

Drejtor Ekzekutiv

Ztr. Afrim Maliqi

Menaxhere e Financave

Shqipdona Hashani

Kontabilist

Xhevdet Leci

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor,	
		2021	2020
Të hyrat			
Te hyrat nga grantet		329,393	269,774
Te hyra te tjera			
Te liruara nga grantet e shtyerapërasete fikse	5	8,960	36,403
Të hyrat		338,353	306,177
Shpenzimet			
Kosto e personelit	7	(186,039)	(122,226)
Shpenzimet e programit	8	(88,557)	(112,984)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	9	(54,797)	(34,564)
Shpenzimet e zhvlerësimit	5	(8,960)	(36,403)
Total shpenzimet		(338,353)	(306,177)
Suficiti i vitit			-

Pasqyra e rrjedhës së parasë

	Fundi i vitit 31 Dhjetor	
	2021	2020
	(në EUR)	(në EUR)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese		
(Deficiti)/suficiti gjatë periudhës		-
Zhvlerësimin	8,960	36,403
Ndryshimet në të arkëtueshme	2,029	(1,717)
Ndryshimet në të arkëtueshme tjera		
Ndryshimet në të pagueshme	1,320	(3,387)
Ndryshimet në detyrime tjera	5,551	40,832
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative	17,860	72,131
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja e pronës dhe e pajisjeve		
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		0
Ndryshimet neto në para dhe ekuivalent	17,860	72,130
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 01 Janar	373,772	301,642
Paraja dhe ekuivalentet më 31 Dhjetor	391,632	373,772

Pasqyra e ndryshimeve ne fonde

	Fondet
	(në EUR)
Gjendja fillestare më 01 Janar ,2020	-
Suficiti i vitit 2020	<hr/> -
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	-
Deficiti i vitit 2021	<hr/>
Gjendja më 31 Dhjetor 2021	<hr/> <hr/>

1. Informata te përgjithshme

HandiKos është regjistruar si organizatë joqeveritare në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/22, Neni 10, për regjistrimin dhe veprimtarinë e OJQ-ve në Kosovë, numri i regjistrimit 5100034-0.

HandiKos (Shoqata e Paraplegjikëve dhe Fëmijëve të Paralizuar të Kosovës) është OJQ lokale, agjenci udhëheqëse në Kosovë për promovimin e drejtave të personave me aftësi të kufizuar të themeluar me 1983.

HANDIKOS është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë. Është organizatë e personave dhe për personat me aftësi të kufizuar.

Me mbi tridhjetë vjet eksperiencë, HandiKOS është e vetmja organizatë e cila ofron me profesionalizëm shërbime cilësore dhe mjete ndihmëse sipas nevojës për persona me aftësi të kufizuara në vend, duke implementuar Programin e Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi, Gjatë kësaj eksperiencë të gjatë, dhe me asistencën dhe mbështetjen e shumë donatorëve dhe artnerëve vendas dhe të huaj, HandiKOS ka arritur të krijoj një besueshmëri të lartë tek më shumë se 18,000 anëtarët e saj, familjarët e tyre, institucionet dhe shoqëria. HandiKOS vazhdon të jetë një nga të vetmet institucione në Kosovë, puna e të cilës informohet nga personat me aftësi të kufizuara fizike dhe të kombinuara, duke avokuar dhe lobuar për përmbushjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Misioni

Të arrijë ndryshime pozitive dhe të qëndrueshme në jetën e personave me aftësi të kufizuara, përmes përfaqësimit, mbrojtjes së të drejtave dhe përkrahjes së tyre.

Vizioni

Shoqëri gjithëpërfshirëse, me njohje dhe realizim të plotë të të drejtave dhe mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara.

Qëllimi

Fuqizimi i personave me aftësi të kufizuara për pjesëmarrje në shoqëri.

Objektivat:

- 1.Pjesëmarrja; 2.Punësimi; 3. Edukimi dhe trajnimi; 4. Mirëqenia sociale; 5.Shëndeti;
6. Zhvillimi organizativ;

Adresat e organizatës është: Dardania 4/7, 10000, Prishtinë, Kosovë.

2. Bazat e përgatitjes dhe politikat e rëndësishme te kontabilitetit

2.1 Politikat e rëndësishme te kontabilitetit

a) Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me Parimet e Përgjithshme të Pranueshme të Kontabilitetit.

b) Bazat e përgatitjes dhe prezantimit

Pasqyrat financiare janë të prezantuara në Euro. Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me konventën e kostos historike. Politikat e kontabilitetit janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme, dhe përveç nëse ceket ndryshe, ato janë të njëjtat me politikat aplikuar në vitin paraprak.

Periudha raportuese e organizatës është 12 muaj duke mbaruar me 31 Dhjetor të secilit vit. Pasqyrat Financiare janë përgatitur në baza krahasuese duke reflektuar bilancet e këtij vitit dhe të atij paraprak.

c) Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë bilancet e parasë së gatshme dhe ato të depozituara në bankat vendore.

d) Prona, impiantet dhe pajimet

Zërat e përfshirë në këtë kategori përfaqësojnë vetura, pajisjet e zyrës dhe pajisjet e teknologjisë informative dhe njihen si asetë vetëm kur është e mundur që:

- benefitet e ardhshme ekonomike të lidhura me asetin do të rrjedhin në Organizatë dhe
- kosto e asetit mund të matet me besueshmëri.

Asetet fillimisht regjistrohen sipas koston. Kostoja përfshin të gjitha shpenzimet direkt të atribueshme në përvetësimin e zëri.

Organizata e mban asetet në kosto historike minus zhvlerësimi i akumuluar apo humbjet e akumuluar te demit, nëse ka. Zhvlerësimi i aseteve regjistrohet në baza vjetore duke përdorur metodën lineare dhe duke pas parasysh jetëgjatësinë e aseteve. Normat e aplikuar të zhvlerësimit janë:

- Veturat - 20 %
- Pajisjet tjera – 20 %

e) Grantet

Grantet janë njohur vetëm kur ka siguri të arsyeshme se:

- Organizata do të përmbushë të gjitha kushtet e bashkangjitura atyre; dhe

- grantet do të pranohen.

Grantet operative janë njohur si e hyrë përgjatë periudhës së nevojshme për ti lidhur ato me kostot, për të cilat janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike. Grantet e shënuara për përvetësimin e pasurive janë shtyrë dhe njohur si e hyrë përgjatë kohës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

f) Llogarite e pagueshme

Llogaritë e pagueshme janë njohur kur shuma është e përcaktueshme dhe obligimi për të shlyer shumën ekziston si rezultat i operacioneve të Organizatës. Ato janë paraqitur në kosto.

a) Shpenzimet

Shpenzimet njihen ne momentin kur ndodhin.

b) Valutat e huaja

Transaksionet në valuta të huaja janë regjistruar në pajtueshmëri me normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Ndryshimet janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave si fitime/humbje.

Ne funde te vitit, bilancet e mbetura ne valuta te huaja janë konvertuar duke përdorur kursin e këmbimit ne ditën e fundit te periudhës raportuese. Fitimet apo humbjet nga këto këmbime janë njohur ne pasqyrën e te ardhurave.

c) Tatimi ne fitim

Organizata është e liruar nga tatimi ne fitim.

d) Te hyrat & shpenzimet

Gjate kësaj periudhe, Organizata ka pranuar gante për te financuar aktivitet dhe operacionet e projekteve. Grantet janë pranuar për projekte specifike te dorëzuara tek donatoret dhe te aprovuara prej tyre.

3. Paraja dhe ekuivalentet e parasë

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
	(në EUR)	(në EUR)
Paraja e gatshme	382	372,836
Paraja në banka	386,650	936
Totali parasë dhe gjendjes në bankë	387,032	373,772

4. Grantet e arketueshme

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
	(in EUR)	(in EUR)
Të arkëtueshme nga donator tjerë	1,590	1,590
Të arkëtueshme tjera	4,649	2,078
Total	6,239	3,668

5. Prona dhe pajisjet

	Objektet	Automjetet	Mobilje dhe pajisje tjera	Totali
Me 01 Janar 2021	572,859	78,798	35,702	687,359
Blerjet gjate vitit				0
Me 31 Dhjetor 2021	572,859	78,798	35,702	687,359

Zhvlerësimi I Akumuluar

Me 01 Janar 2021	(571,659)	(61,531)	(31,782)	(664,973)
Zhvlerësimi I vitit	(1,200)	(5,800)	(1,960)	(8,960)
Me 31 Dhjetor 2021	(572,859)	(67,331)	(33,742)	(673,933)

Vlera neto ne libra

Me 01 Janar 2021	1,200	17,266	3,920	22,386
Me 31 Dhjetor 2021	0	11,467	1,959	13,426

	Objektet	Automjetet	Mobilje dhe pajisje tjera	Totali
Me 01 Janar 2020	572,859	78,798	35,702	687,359
Blerjet gjate vitit				-
Me 31 Dhjetor 2020	572,859	78,798	35,702	687,359

Zhvlerësimi I Akumuluar

Me 01 Janar 2020	(543,016)	(55,733)	(29,822)	(628,570)
Zhvlerësimi I vitit	(28,643)	(5,800)	(1,960)	(36,403)
Me 31 Dhjetor 2020	(571,659)	(61,532)	(31,782)	(664,973)

Vlera neto ne libra

Me 01 Janar 2020	29,843	23,066	5,880	58,788
Me 31 Dhjetor 2020	1,200	17,266	3,920	22,386

6. Të hyrat e shtyera

	31 Dhjetor2021 (në EUR)	31 Dhjetor 2020 (në EUR)
Të hyrat e shtyera për shpenzime operative	387,629	373,122
Të hyrat e shtyera për asete fikse	13,426	22,258
Totali i të hyrave të shtyera	401,054	395,380

Lëvizjet në të hyrat e shtyera:

	31 Dhjetor2021	31 Dhjetor 2020
<u>Me 1 janar:</u>	395,380	354,548
Te pranuar gjatë vitit	343,899	350,767
Te dhëna të tjerëve		(3,758)
Total	739,280	701,557
<u>Te njohura të hyra gjat vitit</u>		
Për shpenzime operative		(269,775)
Për asete fikse	(329,390)	(36,403)
	(8,960)	
Me 31 Dhjetor	400.931	395,380

7. Kosto e personelit

	Viti që përfundon me 31 Dhjetor,	
	2021	2020
Pagat bruto	177,193	115,657
Kontributet pensionale	8,845	6,569
	186,039	122,226

8. Shpenzimet e programit

	Viti që përfundon me 31 Dhjetor,	
	2021	2020
Shpenzimet e auditimit	4,000	3,700
Shpenzimet për punëtori	13,544	23,657
Shpenzimet për transport	2,800	1,930
Vlerësim dhe rivlerësim i strategjive operuese	11,847	17,970
Zyrtar avokues-BE	8,904	8,904
Zyrtar i projektit-BE	9,444	9,444
Pije dhe ushqim për pjesëmarrësit		1,013
Shpenzimet për kamping	656	6,691
Shpenzimet e karburantit		955
Trajnimet dhe shpenzimet për seminare	3,438	4,513
Mbështetës afatshkurta të programit-aktiviteteve	26,135	27,867
Shpenzime tjera	7,788	6,340
	88,557	112,984

9. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative

	Viti që përfundon me 31 Dhjetor,	
	2021	2020
Karburante	7,540	6,769
Shpenzimet bankare	829	909
Energjia elektrike	2,947	2,590
Mirëmbajtja	17,969	3,887
Komunikimi	1,860	2,469
Shpenzimet e zyrës	7,540	3,548
Shpenzimet e udhëtimit		6,102
Shpenzimet tjera	16,112	8,290
Total	54,797	34,564